



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.07.2024

Nr: 152

Ora: 17:27

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT”, PËR  
AKREDITIMIN E VËZHguesVE PËR VËZHgIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME  
PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot në datën 30.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** “Komiteti Shqiptar i Helsinkit”, me adresë në Rr. "Brigada e VIII", Kulla "Tekno Projekt", Hyrja 2, Apartamenti 10, Kati 6;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 30.07.2024  
Ora: 17:27

Nr: 152



Për shqyrtimin e kërkesës, për akreditimin e vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 4 gusht 2024

## V Ë R E J:

“Komiteti Shqiptar i Helsinkit” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 23.07.2024 .

Nga përmbajtja e kërkesës si dhe e dokumentacionit shoqërues rezulton se ajo (kërkesa) nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 6 të Kodit zgjedhor.

- a) Kërkuesi, nuk është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, sikurse përcakton neni 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.
- b) Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.
- c) Dokumentacioni shoqërues i kërkesës nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

## PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S :

1. Mospranimin e kërkesës së “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” për akreditimin e disa vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 30.07.2024      Nr: 152  
Ora: 17:27



Për shqyrtimin e kërkesës, për akreditimin e vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 4 gusht 2024